



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Data/Date:	04.09.2024
Nga/Od/From	Grupi punues
Për/Za/To:	Shaqir Totaj, Kryetar i Komunës së Prizrenit
CC	Antigona Bytyqi, Kryesuese e Kuvendit Komunal të Prizrenit
Tema/Subjekat/Subject	Raporti (me komente) për ecurinë e konsultimit për Raporti për-Projekt-Planin Zhvillimor të Arsimit 2025-2027

Ky raport është përgatitur duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ (MAPL) Nr. 04/2023 për Administratë të Hapur në Komuna me theks neni 30-Mbledhja e komenteve, komunikimi dhe adresimi i tyre.

Publikimet:

Publikimet janë bërë me **08.08.2024** në webfaqe zyrtare të komunës, në facebook-un e komunës, si dhe në platformën e konsultimeve publike:

Në webfaqe:

<https://kk.rks-gov.net/prizren/wp-content/uploads/sites/26/2024/08/Njoftim-per-organizimin-e-konsultimit-publik-per-Projekt-Planin-Zhvillimor-te-Arsimit-2025-2027-Shq-Bosh-Tur.pdf>

Në facebook:

<https://www.facebook.com/share/p/wTMHnqjbHWoLoWvk/?mibextid=oFDknk>

Në platformë:

<https://konsultimet.rks-gov.net/viewConsult.php?ConsultationID=42573>

Njoftimi si lajm në webfaqe:

<https://kk.rks-gov.net/prizren/news/njoftim-per-organizimin-e-konsultimit-publik-per-projekt-planin-zhvillimor-te-arsimit-2025-2027/>

Me 12.08.2024, njoftimi dhe plani (në tri gjuhë) u është dërguar përmes emailit, qytetarëve, klubet sportive, OJQ, organizata të ndryshme, drejtor të shkollave, bizneseve, organizatat studentore, ekspert të fushave, mediat lokale, shoqatave të ndryshme si dhe organizata rinore, që të kenë mundësi të njihen më detajshëm me dokumentin në fjalë, sepse disa nga ta nuk kishin pasur mundësi ta lexonin të publikuar në ueb faqe.

Me 26.07.2024, është mbajtur konsultimi publik, vegëza e publikimit të lajmit për mbajtjen e konsultimit:

Në webfaqe:

<https://kk.rks-gov.net/prizren/news/mbahet-konsultim-publik-per-projekt-planin-zhvillimor-te-arsimit-2025-2027/>

Në facebook:

<https://www.facebook.com/share/p/637A7KQfW7Gh1pVh/?mibextid=oFDknk>

30.08.2024, është publikuar procesverbali për mbajtjen e konsultimit publik, procesverbali është i publikuar në këtë vegëz:

<https://kk.rks-gov.net/prizren/wp-content/uploads/sites/26/2024/08/Procesverbali-per-Projekt-Planin-Zhvillimor-te-Arsimit-2025-2027-PDF-SCAN.pdf>

Dokumenti ka qenë në konsultim publik në uebfaqen zyrtare të komunës dhe platformën e konsultime publike, nga data **08.08.2024** deri me **23.08.2024**, ndërsa komentet janë pranuar deri me datë **23.08.2024**.

Tabelori me të dhëna të shkurtra:

Metodat e konsultimit	Data / Kohëzgjatja	Numri i pjesëmarrësve	Numri i atyre që kanë dhënë komente, kërkesa / sugjerime	Numri i kërkesave të pranuara
1-Takime i drejtpërdrejtë me qytetarë për-Projekt-Planin Zhvillimor të Arsimit 2025-2027	16.08.2024 Nga- Deri-	F M T	2	9 2-Pjesërisht 7-Refuzohen 0-Pranuara

Nr	Kërkesat /Sugjerimet / Komentet	Kush ka dhënë kërkesë/sugjerim	Statusi i kërkesës: Pranuar: Pjesërisht: Refuzuar:	Arsyetimi (komentimi për pranimin pjesërisht dhe mos pranimit të komenteve është i detyrueshëm)
1	1.Propozoj që të përfshihen programet e mendimit kritik në bibliotekat e shkollave, ku theksoj rekomandimin që të gjitha shkollat të kenë bibliotekën e vetë dhe komuna t'i pajisë me libra.	Vlora Karavidaj- drejtoreshë në shkollën fillore “Lekë Dukagjini”	Pjesërisht	Vet korniza kurrikulare ka synim zhvillimin e mendimit kritik tek fëmijët. Megjithatë në Planin Zhvillimor të Arsimit do të planifikohen masa që të dinamizojnë bibliotekat e shkollave, fillimisht duke hartuar udhërrëfyes për zhvillimin e aktiviteteve që zhvillojnë mendimin kritik përfshirë kultivimin e shprehivë të të lexuarit.
2	1.Përmirësimi i Infrastrukturës dhe Pajisjeve- Investimi në ndërtimin dhe rinovimin e sallave të provave dhe të koncerteve, duke përfshirë akustikën e duhur.-Sigurimi i instrumenteve muzikore cilësore dhe pajisjeve të nevojshme për mësim dhe praktikë, përfshirë piano, violina, kitarra, etj. - Krijimi i laboratorëve muzikorë të pajisur me teknologji moderne për kompozim, regjistrim dhe miksim.	Vesel Krasniqi- Drejtor i shkollës së muzikës "Lorenc Antoni" (koment i pranuar në formë elektronike)	Pjesërisht	Objekti ekzistues i shkollës së muzikës nuk ka hapësira të mjaftueshme për të ndërtuar salla të provave dhe të koncerteve. Rinovimet në shkollë janë të vonshme. Megjithatë, është planifikuar ndërtimi i objektit të ri shkollor, i cili do të jetë i destinuar për zhvillim të mësimit muzikor. Lidhur me furnizimin me pajisje muzikore, është e drejtë dhe do të përfshihet në Planin Zhvillimor të Arsimit, përfshirë furnizimin me pajisje muzikore edhe për shkollat e mesme të ulëta.

2. Rishikimi dhe Përmirësimi i Kurrikulës-Rishikimi i programeve mësimore për t'i përmbushur standardet ndërkombëtare dhe për të përfshirë praktikën më të mirë pedagogjike. - Zgjerimi i kurrikulës për të përfshirë lëndë si teoria e muzikës, historia e muzikës, teknologjia muzikore dhe improvizimi.-Përfshirja e metodave bashkëkohore të mësimdhënies që kombinojnë teknikat tradicionale me ato moderne.		Refuzohet	Rishikimi i kurrikulës nuk është kompetencë e komunës
3.Zhvillimi Profesional i Mësuesve: - Organizimi i trajnimeve të vazhdueshme për mësuesit, duke përfshirë teknikat e reja pedagogjike dhe përmirësimin e aftësive muzikore.-Krijimi i mundësive për mësuesit për të marrë pjesë në konferenca dhe seminare kombëtare dhe ndërkombëtare për shkëmbimin e përvojave.		Refuzohet	Zhvillimi profesional i mësimdhënësve është objektivë e Planit Zhvillimor të Arsimit, në të cilën shkollat organizojnë në mënyrë të pavarur trajnimet me bazë në shkollë, varësisht prej nevojave që i kanë për trajnime
4.Identifikimi dhe Zhvillimi i Talenteve Muzikore-Krijimi i programeve të personalizuar për nxënësit me talent të veçantë, duke ofruar mbështetje të specializuar.-Organizimi i konkurseve dhe festivaleve muzikore për të promovuar talentet dhe për të inkurajuar pjesëmarrjen e nxënësve.		Refuzohet	Shkolla duhet të krijojë vet mekanizma që identifikojnë nxënësit që kanë dhunti, sikurse edhe për nxënësit me vështirësi në të nxënë. Shkolla e ka pavarësinë të zhvillojë dhe organizojë ngjarje publike muzikore.
5.Integrimi i Teknologjisë në Arsimin Muzikor: - Përdorimi i programeve dhe aplikacioneve muzikore për të ndihmuar nxënësit në mësimin e teorisë, kompozimit dhe solfezhit. - Krijimi i mundësive për të realizuar projekte muzikore dixhitale dhe për të përdorur teknologjinë në krijimin e muzikës.		Refuzohet	Shkolla e ka pavarësinë të krijojë mundësi për integrimin e veglave / programeve digjitale në funksion të rritjes së cilësisë së të nxënit dhe të arritjeve të sukseseve.
6. Përfshirja e Koncerteve dhe Shfaqjeve në Programin Edukativ: - Organizimi i koncerteve të rregullta për nxënësit si pjesë e procesit të vlerësimit dhe promovimit të aftësive të tyre.-Bashkëpunimi me institucione muzikore dhe orkestrat për të krijuar mundësi të performancës dhe bashkëpunimit për nxënësit.		Refuzohet	Në shkollën e muzikës instrument i vlerësimit është edhe përfshirja e nxënësve në organizim dhe performim të ngjarjeve muzikore. Gjithashtu pjesë e punës së shkollës është bashkëpunimi me institucionet tjera të artit/muzikës.

7.Bashkëpunimi me Institucionet Muzikore dhe Komunitetin- Krijimi i partneriteteve me konservatorët, orkestrat simfonike, ansamblet dhe shkollat e tjera muzikore për të ofruar mundësi shkëmbimi dhe bashkëpunimi.-Përfshirja e komunitetit në aktivitete dhe projekte muzikore që promovojnë kulturën dhe edukimin muzikor.		Refuzohet	Bashkëpunimi dhe partneritetet me institucionet tjera dhe me komunitetin është pjesë integrale e punës së shkollës.
8.Mbështetje Psikologjike dhe Motivimi për Nxënësit-Ofrimi i programeve mbështetëse për të menaxhuar stresin dhe për të ruajtur motivimin gjatë procesit të mësimi dhe përgatitjes artistike. - Krijimi i mundësive për mentorim dhe këshillim karriere për nxënësit që synojnë të ndjekin studimet muzikore në nivel të lartë. Objektivat Afatmesme dhe Afatgjata:-Rritja e cilësisë së arsimit muzikor dhe përgatitja e nxënësve për karrierë profesionale në muzikë. - Zhvillimi i shkollave të muzikës si qendra të ekselencës në edukimin muzikor në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.- Zgjerimi i qasjes së edukimit muzikor përmes integrimit të programeve që përfshijnë komunitetin dhe kulturën lokale. Ky plan është një udhërrëfyes i rëndësishëm për zhvillimin e arsimit muzikor dhe për të siguruar një platformë të fortë për talentet e reja në fushën e muzikës.		Refuzohet	Është detyrë e përditshme e psikologut shkollor që t'i mbështetë nxënësit dhe komunitetin arsimor brenda shkollës për performim cilësor, qoftë në adresimin e sfidave sikurse stresi etj, qoftë në motivimin për performancë më të mirë.

Shkurtesat:

F-Femra, M-Meshkuj, T-Totali

Bashkangjitur në këtë raport janë edhe këto dokumente:

1. Njoftimin për mbajtjen e konsultimit publik, Projekt-Planin Zhvillimor të Arsimit 2025-2027
2. Lista e nënshkrimeve të qytetarëve pjesëmarrës në konsultimin publik.

Raporti është përgatitur nga :

Haziz Krasniqi
